



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2023

VENDIM

Nr. 524, datë 05.10.2023

PËR

CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM LEZHË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Besmir Stroka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: Nenet 79/dh e 25, 278/1-4 të Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Sokol Shehu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: Nenet 76-22 dhe 278/1 të Kodit Penal.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Besmir Stroka dhe Sokol Shehu, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; Akuza: Nenet 79/c dhe 278/1 të Kodit Penal.

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Sokol Shehu dhe Besmir Stroka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: Nenet 78/2-25 të Kodit Penal.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Besmir Stroka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...} dhe {...} Akuza: Nenet 101/1, 278/5, 114/2 dhe 283/2 të Kodit Penal (Dërgim për gjykim).

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM BERAT

1. Gjyqtaret e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Miranda Nakaj dhe Ersida Bajgora, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Akuza: “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë.

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM GJIROKASTËR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, Dejvi Çelçima, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehur: {...}, {...}; Akuza: Vjedhje me dhunë dhe Heqje e paligjshme e lirisë – nenet 110/2 dhe 134/2 të Kodit Penal.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR